



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 11 dhe 12.2 shkronja d) të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, nenin 18 të Ligjit nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenin 18 të Rregullores (QRK) 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, si dhe në mbështetje të nenet 14 dhe 15 paragrafi 2.4 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 31 mars 2026, miratoi këtë,

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE NË PROCEDURËN E DHËNIES NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

Neni 1

1. Për shqyrtimin e ankesave në procedurën e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, formohet komisioni në këtë përbërje;

- 1.1. **znj. Adelina Stublla**, nga Kuvendi i Komunës
- 1.2. **z. Valdet Restelica**, nga Kuvendi i Komunës
- 1.3. **z. Avni Fetahu**, nga Ekzekutivi i Komunës
- 1.4. **z. Ahmet Ahmeti**, nga Ekzekutivi i Komunës
- 1.5. **znj. Shukrie Neziri**, nga sektori joqeveritar lokal

2. Kryesuesi i Komisionit zgjedhet me shumicën e votave të anëtarëve të këtij komisioni dhe i njëjti organizon dhe kryeson punën e komisionit.

Neni 2

Mandati i Komisionit sipas nenit 1 të këtij vendimi është 2 vjeçar brenda mandatit të Kuvendit të Komunës.

Neni 3

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë të përcaktuara me Ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe Rregulloren QRK nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 4

Drejtoritë dhe shërbimet tjera përkatëse të Administratës së Komunës i ofrojnë përkrahje Komisionit të caktuar me këtë vendim.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit Pushtetit Lokal dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform dispozitave të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale, Ligjit nr.08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, si dhe Rregullores (QRK) nr.03/2026 për procedurën e shqyrtimit administrativ të akteve të komunave.

Nr.Prot. 01-020/04-0019213/26
Podujevë, datë; 31 mars 2026

